

# GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

## SEKSIONI I TRETË

### ÇËSHËTJA MAHO kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 24908/18)

VENDIM  
STRASBURG  
12 dhjetor 2024

*Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.*

#### Në çështjen Maho kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *President,*

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Pas diskutimit me dyer të mbyllura, më 21 nëntor 2024,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

#### PROCEDURA

1. Çështja fillon me depozitimin në Gjykatë të një kërkesë kundër Shqipërisë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga tre kërkesues, më 24 maj 2018.

2. Kërkesit u përfaqësuan nga znj. S. Mëneri, avokate e licencuar në Tiranë.

3. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u njoftua për kërkesën.

#### FAKTET

4. Detajet e kërkesve dhe informacion në lidhje me kërkesën jepen në tabelën bashkëngjitur.

Ata u ankuar për mosekzekutimin e një vendimit të brendshëm në favor të tyre.

#### I. MARRËVESHJA E VITIT 1989

5. Më 3 qershor 1989, A. M dhe ish-Komiteti Ekzekutiv në Tiranë, degë e pushtetit vendor, nënshkruan një marrëveshje sipas së cilës A. M do të hiqte dorë nga qiramarrja e një apartamenti në pronësi të shtetit të cilin e kishte marrë me qira. Në këmbim Komiteti Ekzekutiv i Tiranës do t'i jepte të drejtën e qirasë së një apartamenti të ri, në një ndërtesë që ishte në ndërtim e sipër.

6. Më 27 korrik 1999, A. M ndërroi jetë dhe më 20 shtator 1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë njohu kërkesit si trashëgimtarë të tij.

#### II. VENDIMI I VITIT 2007

7. Më 14 qershor 2005, kërkesi i dytë dhe i tretë depozituan një padi në gjykatë kundër Bashkisë Tiranë, si pasardhëse e Komitetit Ekzekutiv të Tiranës. Ata u bazuan në legjitimitimin e tyre si trashëgimtarë të A. M dhe kërkuan që Bashkia të ekzekutojë marrëveshjen e vitit 1989 në favor të tyre.

8. I padituri insistoi që pretendimi të zgjidhej bazuar në legjislacionin e ri të zbatueshëm për strehimin social.

9. Më 8 shkurt 2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e refuzoi atë mbrojtje duke konstatuar se legjislacioni i ri i zbatueshëm për strehimin social nuk e shfuqizonte detyrimin e Bashkisë për të zbatuar marrëveshjen e vitit 1989 (vendimi i vitit 2007).

10. Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, më 20 shkurt 2008 dhe 12 mars 2010, përkatësisht, refuzuan ankimin e të paditurit dhe lanë në fuqi vendimin e vitit 2007.

### III. PROCEDURA E EKZEKUTIMIT

11. Më 21 prill 2008, Gjykata e Rrethit Tiranë nxori një urdhër ekzekutimi, në lidhje me vendimin e vitit 2007.

12. Më 23 nëntor 2017, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të së drejtës së kërkuesit të dytë dhe të tretë për proces të drejtë gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit të vitit 2007 nga autoritetet.

#### LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6, PARAGRAFI 1 TË KONVENTËS, PËR SHKAK TË MOSEKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË VITIT 2007

13. Kërkuesit u ankuan sipas nenit 6, paragrafi 1 të Konventës, për mosekzekutimin e vendimit të vitit 2007.

#### A. Pranueshmëria

14. Gjykata vëren se kërkuesja e parë nuk ishte palë në procesin përpara gjykatave të brendshme dhe të drejtat e saj nuk kishin qenë asnjëherë objekt shqyrtimi në nivelin e brendshëm, sidomos në kuadër të proceseve që çuan në vendimin e vitit 2007, ekzekutimi i të cilit është thelbi i kësaj kërkese (shihni paragrafët 7 dhe 12 më sipër). Në këto rrethana, ajo nuk mund të pretendojë që është viktimë e shkeljes së pretenduar sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës. Vijon që kërkesa, në masën që është paraqitur nga kërkuesja e parë, nuk është në përputhje *ratione personae* me dispozitat e Konventës dhe prandaj duhet të refuzohet, në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 dhe 4, të Konventës.

15. Më tej, gjykata vëren se ankimi i kërkuesit të dytë dhe të tretë nuk është qartazi i pabazuar apo i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

#### B. Themeli

16. Gjykata thekson se ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore” për qëllime të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës gjyqësore, në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, 40, *Raporte të Vendimeve* 1997 II).

17. Në çështjet kryesuese *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 38–45, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 55–61, 29 shtator 2009), Gjykata tashmë ka gjetur shkelje, në lidhje me probleme të ngjashme me ato të kësaj çështjeje.

18. Qeveria nuk e kundërshtoi faktin që vendimi i vitit 2007 nuk ishte ekzekutuar. Ajo parashtroi se programi ekzistues i strehimit i Bashkisë Tiranë përfshinte qiranë për strehimin social, kreditë e buta dhe të subvencionuara për blerjen e vendbanimit kryesor, dhe subvencionimin e qirasë. Ajo u shpreh që kërkuesit duhet të aplikojnë pranë Bashkisë për një nga këto programe.

19. Kërkuesit argumentuan që kuadri ligjor ekzistues për strehimin social nuk ofronte garanci të mjaftueshme për çështjet e tyre specifike.

20. Gjykata vëren që sipas vendimit të vitit 2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës kishte urdhëruar Bashkinë e Tiranës që të ekzekutonte marrëveshjen e vitit 1989, pa marrë parasysh legjislacionin për strehimin social që kishte hyrë në fuqi pas lidhjes së marrëveshjes së vitit 1989 (shihni paragrafin 9 më lart). Gjykata Kushtetuese gjeti që vendimi i vitit 2007 nuk ishte ekzekutuar (shihni paragrafin 12 më lart). Gjithashtu, qeveria nuk e kundërshtoi atë gjetje. Fakti që kërkuesit mund të aplikojnë për strehim social sipas legjislacionit të ri në fuqi nuk ndikon në atë konkluzion.

21. Prandaj, Gjykata vëren se që në 12 mars 2010, kur Gjykata e Lartë refuzoi ankimin e fundit (shihni paragrafin 10 më lart), vendimi i vitit 2007 vazhdoi të mos ekzekutohej dhe autoritetet e brendshme nuk arritën të bëjnë të gjitha përpjekjet e nevojshme për ekzekutimin e tij. Nga kjo vijon që është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

#### II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENEVE 8 DHE 13 TË KONVENTËS

22. Kërkuesit, gjithashtu, u ankuan sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës, për një shkelje të pretenduar të së drejtës së tyre për banesë dhe për mungesën e një zgjidhjeje efektive, në lidhje me ankimin e tyre për mosekzekutimin e vendimit të brendshëm të formës së prerë.

23. Duke pasur parasysh faktet e çështjes, parashtrimet e palëve dhe gjetjet e saj, Gjykata vlerëson se ka shqyrtuar pyetjen kryesore ligjore të ngritur në këtë çështje. Kështu, ajo gjen që nuk ka pse të marrë një vendim të veçantë për këto ankime (shihni *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë* [DHM], nr. 47848/08, § 156, GJEDNJ 2014).

### III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

24. Në lidhje me dëmin pasuror, dy kërkuesit pretenduan shuma të ndryshme në varësi të metodës së llogaritjes së çmimit të qirasë në Tiranë për apartamente të ngjashme me atë që prisnin të merrnin, sipas marrëveshjes së vitit 1989. Ata, gjithashtu, u shprehën që kishin humbur mundësinë për të fituar titullin e pronësisë për një apartament në pronësi të shtetit sipas ligjeve specifike të privatizimit (shihni *Kasmi kundër Shqipërisë*, nr. 1175/06, § 8, 23 qershor 2020). Njëkohësisht, ata nuk paraqitën ndonjë provë për shpenzimet aktuale të qirasë që duhej të përballonin.

25. Gjykata nuk mund të spekulojë për ndonjë mundësi të mundshme për të fituar pronësinë e një apartamenti *via* procesit të privatizimit dhe nuk është gati që t'ju japë kërkuesve kompensim për dëm pasuror bazuar në një studim abstrakt të çmimeve të qirasë. Prandaj nuk merr asnjë vendim nën këtë zë.

26. Në lidhje me dëmin jopasuror, kërkuesit pretenduan 30.000 euro (EUR). Ata pretenduan edhe 3,000 euro për kosto dhe shpenzime të kryera përpara Gjykatës. Qeveria i konsideroi këto shuma të tepruara dhe të panevojshme.

27. Duke pasur parasysh dokumentet që dispononte dhe praktikën e saj gjyqësore (shihni, në veçanti, *Qufaj Co. sh.p.k.* cituar më sipër, §§ 46–48, dhe *Gjyli*, gjithashtu të cituar më sipër, §§ 62–76), Gjykata vlerëson të arsyeshme shumat e treguara në tabelën bashkëngjitur që duhet t'i paguhen bashkërisht kërkuesit të dytë dhe të tretë.

28. Gjykata vëren më tej se shteti i paditur ka një detyrim të papërbushur për të zbatuar vendimin e vitit 2007, i cili mbetet i ekzekutueshëm. Në të njëjtën kohë, Gjykata thekson se i takon më së shumti shtetit të paditur që të zgjedhë mjetet që do të përdoren në rendin e tij juridik të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, sipas nenit 46 të Konventës (shihni *Shofman kundër Rusisë*, nr. 74826/01, § 53, 24 nëntor 2005, me referenca të mëtejshme).

#### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. *shpall* të pranueshëm ankimin e paraqitur sipas nenit 6 § 1 të Konventës nga kërkuesi i dytë dhe i tretë, *vendos* që ankimi i ngjashëm sipas nenit 6 § 1 të Konventës i paraqitur nga kërkuesja e parë është i papranueshëm, dhe *gjen* që nuk ka nevojë të shqyrtojë veçmas ankimet e mbetura;

2. *shprehet* që është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me kërkuesin e dytë dhe të tretë, për shkak të mosekzekutimit të vendimit të vitit 2007;

3. *vendos* që shteti i paditur, me anë të mjeteve të duhura, brenda tre muajve, të sigurojë ekzekutimin e vendimit të vitit 2007;

#### 4. *Vendos*:

a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkuesve bashkërisht, brenda tre muajve, shumat e treguara në tabelën bashkëngjitur, që do të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet kamatvonesë e thjeshtë për shumat e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 dhjetor 2024, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

**Viktoriya Maradudina**  
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

**Oddný Mjöll Arnardóttir**  
PRESIDENT

## SHTOJCË

### Kërkesa që paraqet ankimet sipas paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës (mosekzekutimi i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Legjislacioni i brendshëm përkatës	Data e fillimit të periudhës së mosekzekutimit	Data e mbarimit të periudhës së mosekzekutimit Kohëzgjatja e procedurave të ekzekutimit	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror (në euro) <sup>1</sup>	Shuma e dhënë për koston dhe shpenzimet (në euro) <sup>2</sup>
24908/18 24.5.2018	<b>Mimoza MAHO</b> 1956	Suella Mëneri Tiranë	-	-	-	-	-
	<b>Arben MAHO</b> 1961  <b>Saime MAHO</b> 1937		Vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë, 8.2.2007	12.3.2010	Në pritje për më shumë se 14 vjet dhe 6 muaj	4.700, bashkërisht për kërkuarët e dytë dhe të tretë	500, bashkërisht për kërkuarët e dytë dhe të tretë

<sup>1</sup> Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarëve.

<sup>2</sup> Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarëve.